



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave

Raporti i punës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Janar - Dhjetor 2023

Prishtinë, Janar 2024

Ky raport paraqet punën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL për periudhën *Janar – Dhjetor 2023*.

Raporti përshkruan aktivitetet e të gjitha njësive organizative të MAPL-së duke u fokusuar në katër fusha kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së ministrisë sipas planit vjetor të punës për vitin 2023.

Raporti është hartuar nga Divizioni për Koordinim të Politikave.

Saktësia e të dhënave është përgjegjësi e departamenteve dhe njësive organizative të MAPL-së.

Përmbajtja

Shkurtesat.....	3
Hyrje.....	4
Përmbledhje ekzekutive	5
I. Krijimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërkufitar	8
1.1. Zhvillimi i kuadrit strategjik për zhvillim ekonomik lokal.....	8
1.2. Financimi i projekteve të komunave.....	8
1.3. Vlerësimi i performancës komunale	9
II. Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërkufitar	10
2.1. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërkufitar.....	10
2.2. Zbatimi i programeve të bashkëpunimit ndërkufitar	11
2.2.1. Programi IPA II Kosovë-Shqipëri 2014-2020.....	11
2.2.3. Programi IPA II Kosovë-Mali i Zi 2014-2020	13
III. Avancimi i politikave dhe i kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale.....	14
3.1. Zhvillimi i akteve ligjore dhe nënligjore.....	14
3.2. Vlerësimi i ndikimit të politikave në fushën e vetëqeverisjes lokale	15
3.3. Monitorimi i kuvendëve të komunave	15
3.4. Adresimi i obligimeve nga agjenda evropiane	16
3.5. Koordinimi i politikave.....	16
IV. Ngritja e transparencës komunale, promovimi i të drejtave të njeriut dhe zhvillimi i kapaciteteve	17
4.1. Aktivitetet në fushën e të drejtave të njeriut dhe transparencën komunale	17
4.2. Hartimi dhe miratimi i Planit Nacional të Veprimit 2023 - 2024 në kuadër Partneritetin për Qeverisje të Hapur - PQH.....	19
4.3. Zhvillimi i platformës shtetërore E-KOMUNAT.....	19
4.4. Informimi i publikut për aktivitetet e MAPL-së.....	19
4.6. Bashkëpunimi me shoqërinë civile.....	20
4.7. Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunal.....	20
V. Administrata, financat, auditimi dhe prokurimi.....	21
5.1. Administrata dhe financat.....	21
5.2. Auditimi i Brendshëm	22
5.3. Prokurimi	23

Shkurtesat

AE	Agjenda Evropiane
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
BB	Banka Botërore
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative
COVID 19	Pandemia e Coronavirusit
ECDC	Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
IE	Integrimet Evropiane
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
LVL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MFT	Ministria e Financave dhe Transfere
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MSA	Marrëveshja për Stabilizim Asociim
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PL	Pushteti Lokal
PKZMSA	Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
PQ	Pushteti Qendror
QOMPAP	Qendra Operative e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
QPKS	Qendra për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjeve
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
QOE	Qendra Operative Emergjente
QPKS	Qendra për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjeve
SDC/DEMOS	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SIDA	Agjensioni Suedez për Zhvillim Ndërkombëtar
SMFK	Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale
SVL	Strategjia për Vetëqeverisje Lokale
SHE	Shtabet Emergjente
SZHEL	Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
USAID	Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik

Hyrje

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në përputhje me mandatin e saj ligjor, objektivat e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016–2026, si dhe Planin Vjetor të Punës për vitin 2023, ka realizuar aktivitetet e planifikuara për periudhën Janar – Dhjetor 2023. Raporti pasqyron arritjet sipas fushave të përcaktuara në këtë plan, të integruara edhe në kuadër të Planit Kombëtarë për Zhvillim. Aktivitetet e raportuara zënë vend në kuadër të pesë objektivat kryesore të punës, si vijon:

- Rritja e zhvillimit ekonomik lokal përmes mbështetjes financiare të komunave të bazuar në performancë;
- Avancimi i bashkëpunimit ndërkomunal, komunal ndërkombëtar dhe ndërkufitar;
- Avancimi i politikave dhe i kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale;
- Ngritja e transparencës komunale, promovimi i të drejtave të njeriut dhe zhvillimi i kapaciteteve
- Administrata dhe financat, auditimi dhe prokurimi.

Raporti bazohet në të dhënat e raportuara për aktivitetet e realizuara nga departamentet dhe njësitë/divizionet e MAPL-së, respektivisht:

- Departamentit për Zhvillim të Qëndrueshëm Komunal;
- Departamentit për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe Ndërkufitar;
- Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave;
- Departamentit Ligjor dhe për Monitorim të Komunave;
- Departamentit për Performancë dhe Transparencë në Komuna;
- Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Divizioni për Komunikim me Publikun;
- Divizioni i Auditimit të Brendshëm;
- Divizioni i Prokurimit.

Lidhur me metodologjinë e raportit, janë marrë për bazë informatat nga njësitë përkatëse të MAPL-së, të cilat janë analizuar dhe janë vendosur sipas objektivave dhe aktiviteteve të caktuara në planin vjetor të punës. Raporti merr për bazë indikatorët sasior dhe cilësor për aktivitetet realizuara dhe është raport dekriptiv mbi aktivitetet e MAPL-së në periudhën Janar – Dhjetor, 2023.

Përmbledhje ekzekutive

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në periudhën Janar – Dhjetor 2023 ka arritur t'i realizoj aktivitetet e parapara të cilat janë pjesë e planit vjetor të punës së MAPL-së për këtë vit. Ky plan është dokument i bazuar në objektivat e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 dhe në dokumentet tjera relevante të qeverisë. Në këtë periudhë është shënuar progres i matshëm në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, plotësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor për vetëqeverisje lokale, përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve komunale, forcimin e transparencës komunale, promovimin e barazisë gjinore, e-qeverisjes, zgjerimin e bashkëpunimit me partnerët/donatorët përmes projekteve të përbashkëta, bashkëpunimi me shoqërinë civile, përmirësimin e koordinimit ndërsektorial, bashkëpunimin ndërkomunal, komunal ndërkombëtar dhe ndërkufitar, ngritjen e kapaciteteve profesionale të komunave dhe shumë fusha të tjera.

Në kuadër të zhvillimit të politikave për Vetëqeverisje Lokale, fokusi është vënë në monitorimin e Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal dhe në kuadër të saj është përgatitur raporti lidhur me implementimin e planit të veprimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal. Gjithashtu është hartuar Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2023-2029, i cili është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Programet për financimin e projekteve kapitale të komunave janë një ndër instrumentet kryesore të mbështetjes direkte të komunave në fushën e zhvillimit ekonomik. Janë përgatitur kriteret për financim të projekteve të komunave në kuadër të *programit për mbështetje për projektet infrastrukturore për komunitete dhe programit për financimin e projekteve kapitale të komunave*. Pas aplikimit të komunave në kuadër të dy këtyre dy programeve janë përzgjedhur gjithsej 23 komuna përfituese me të cilat janë lidhur Marrëveshjet e Mirëkuptimit për financim të projekteve.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal gjatë kësaj periudhe, rëndësi të madhe i ka kushtuar avancimit të sistemit të performancës komunale dhe skemës së grantit të bazuar në performancë. Janë koordinuar aktivitetet me komuna lidhur me materialet e nevojshme për aplikimin e projekteve për Grantin e performancës komunale, si dhe janë përgatitë marrëveshjet e mirëkuptimit për financim të projekteve nga GPK. MAPL, ka pranuar opinionin financiar nga MFPT, dhe me datë, 12.04.2023 lënda e kompletuar është aprovuar nga Qeveria. Nga ky grant janë financuar gjithsej 14 projekte në 6 komuna përfituese sipas kriterëve të përfitimit të grantit. Është hapur thirrja për raportim nga komunat lidhur me matjen e performancës për vitin 2022 si dhe i njëjti raport është finalizuar dhe publikuar, bazuar në Ligjin e Performancës.

Në periudhën Janar – Dhjetor 2023, MAPL ka vazhduar aktivitetet lidhur me mbështetjen e komunave për bashkëpunim ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtarë. Kanë vazhduar aktivitetet me donatorët, respektivisht me OSBE-në lidhur me realizimin e aktiviteteve të përbashkëta për vitin 2023. Janë përgatitur kriteret për financim të projekteve të komunave në fushën e bashkëpunimit ndërkomunal. Në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal dhe bashkëpunimit komunal ndërkombëtar gjithsej janë realizuar 16 nisma/iniciativa për bashkëpunim. Po ashtu në këtë periudhë kohore ka vazhduar avancimi i bashkëpunimit ndërkufitar në kuadër të tri programeve: Kosovë – Shqipëri, Kosovë – Maqedoni dhe Kosovë – Mali i Zi.

Fokus i veçantë i është dhënë edhe zhvillimit dhe avancimit të legjislacionit sipas programit legjislativ për vitin 2023 dhe dokumenteve tjera, të cilat janë hartuar dhe aprovuar, si në vijim: 2 projektligje, 4 udhëzime administrative, 1 vlerësim ex-post dhe 1 koncept dokument.

Në periudhën Janar – Dhjetor 2023, kanë funksionuar kuvendet në 38 komuna të Republikës së Kosovës, duke mbajtur mbledhje rregullisht. Kuvendet e komunave kanë mbajtur 461 mbledhje. Mbledhjet e kuvendeve të komunave janë monitoruar përmes sistemit të teleprezencës, si dhe prezencës fizike të zyrtarëve për komunat: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zvečan dhe Leposaviq. Gjatë kësaj periudhe janë pranuar gjithsej 2010 akte, prej tyre 109 rregullore dhe 1921 vendime të kuvendeve të komunave. Nga gjithsej 2010 akte, MAPL ka vlerësuar 1105 akte, përderisa 905 akte të tjera janë dërguar në Ministrinë e linjës. Janë konstatuar 120 akte të kundërligjshme, prej të cilave janë rishqyrtuar 110 akte, ndërsa 4 akte janë dërguar në Ministrinë e Drejtësisë.

Sa i përket konsultimit paraprak të akteve të ministrive sektoriale dhe përputhshmërisë së tyre me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, është themeluar Grupi Punues brenda ministrisë i cili është përgjegjës për shqyrtimin e akteve për konsultim paraprak, i cili në vazhdimësi pranon akte nga ministrinë e linjës për konsultim paraprak. Ndërsa, lidhur me shkresat njoftuese që adresohen në komuna, në këtë periudhë kohore janë pranuar janë 15 kërkesa për konsultim paraprak, janë pranuar dhe shqyrtuar 274 kërkesa dhe 56 ankesa nga personat fizik dhe juridik.

Me qëllim të pasqyrimin të aktiviteteve të zhvilluara nga kuvendet e komunave është hartuar dhe publikuar Raporti i funksionimit të kuvendeve të komunave për periudhën Janar – Dhjetor 2022.

MAPL ka udhëhequr një proces tejet të rëndësishëm për adresimin e obligimeve të agjendës evropiane në komuna. Në këtë periudhë kohore është hartuar Raporti i përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar-Qershor 2023. Bazuar në të dhënat e ofruar, komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin 47 % të aktiviteteve në fushën e kriterëve politike, 35 % sa i përket kriterëve ekonomike, dhe në fushën e standardeve evropiane ato kanë realizuar 70 % të aktiviteteve. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për vitin 2023 është 50%.

Është vazhduar me mbështetjen e komunave në zbatimin e politikave në fushën e të drejtave të njeriut. Në këtë periudhë është hartuar Raporti vjetor për të drejtat e njeriut për vitin 2022, Analiza e vlerësimit të kapaciteteve të strukturave dhe zyrtarëve komunal për të punuar me grupet e marginalizuara dhe raporti për komunat për mbrojtje nga diskriminimi për periudhën Janar-Qershor 2023.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka filluar procesin e digjitalizimit të shërbimeve komunale përmes zhvillimit të platformës E-KOMUNAT. Kjo platformë do të jetë në shërbim të qytetarëve për të rritur pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje në nivelin lokal, dhe do të jetë në shërbim të vet komunave për digjitalizimin e shërbimeve komunale. Në kuadër të kësaj MAPL si udhëheqëse e këtij procesi gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar fazën e parë të platformës E-Komunat dhe pas lansimit të fazës së parë të platformës E-KOMUNA, MAPL është fokusuar në zhvillimin e fazës së dytë të kësaj platforme e cila është në zhvillim e sipër.

Janë ofruar informata të vazhdueshme për publikun, mediet, shoqërinë civile, organizatat e huaja ndërkombëtare, si dhe palët e interesuara lidhur me aktivitetet e zhvilluara. Kurse, lidhur me qeverisjen e hapur si njëri nga parimet themelore të punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nismën e MAPL, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim që të fillohet me hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit 2023-2025 për qeverise të hapur në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur – PQH i cili dhe është miratuar nga Qeveria. MAPL ka pranuar letrën zyrtare të anëtarësimit të Republikës së Kosovës nga Komiteti Mbikëqyrës i Open Government Partnership. Delegacioni i Republikës së Kosovës ka marrë pjesë në Samitin Global të Open Government Partnership. Republika e Kosovës tashmë figuron në listën e anëtarëve të Open Government Partnership në ueb-faqen zyrtare të saj.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka vazhduar me përfshirjen e shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe legjislacionit për vetëqeverisje lokale dhe në implementimin e strategjisë për vetëqeverisje lokale 2016-2026. Po ashtu, ka vazhduar bashkëpunimi me Forumin Konsultativ për Qeverisje Lokale.

Buxheti i MAPL-së për vitin 2023, (bazuar në raport të datës 26.01.2024 për vitin 2023) së bashku me Donacionin (93 Council of Europe dhe WB-Banka Botërore) është 12,934,069.15 €. Nga kjo shumë për periudhën Janar – Dhjetor nga buxheti i konsoliduar janë shpenzuar 7,349,725.79 € ose 67.29 % e buxhetit. Prej kategorisë së donacionit 93 Council of Europe është shpenzuar shuma 117,441.48 € ose 42.06 % e buxhetit ndërsa nga donacioni EB-Banka Botërore është shpenzuar shuma 449,794.17€ ose 22.49 %. Në total Buxheti i MAPL-së + Donacionet (93 Council of Europe dhe WB-Banka Botërore) për periudhën Janar-Dhjetor është shpenzuar në vlerë prej: 7,856,779.34 € ose 60.74 % e buxhetit

Për fushën e auditimit është hartuar raporti i gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2022 dhe raportit vjetor të punës së NjAB për vitin 2022 dhe janë përfunduar auditimet si *“Menaxhimi i automjeteve në MAPL”* dhe *“Menaxhimi i burimeve njerëzore në MAPL”*. Gjithashtu janë mbajtur katër takime të përbashkëta me Komitetin e Auditimit.

I. Rritja e zhvillimit ekonomik lokal përmes mbështetjes financiare të komunave të bazuar në performancë

Aktivitetet e realizuara në kuadër të objektivit të parë, janë grupuar në 3 fusha kryesore si vijon:

- Hartimit të politikave për zhvillim ekonomik lokal;
- Financimit të projekteve të komunave;
- Menaxhimi i performancës komunale.

1.1. Zhvillimi i kuadrit strategjik për zhvillim ekonomik lokal

MAPL në baza vjetore monitoron dhe raporton për zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019 – 2023. Për këtë qëllim është dërguar shkresa tek komunat dhe ministrinë e linjës për të raportuar lidhur me realizimin e aktiviteteve të dala nga plani i veprimit i SZHEL-së. Janë marr të dhënat nga 31 komuna dhe nga Ministrinë e Linjës, si dhe është përgatitur raporti i planit të veprimit, i cili është dërguar në Zyrën për Planifikim Strategjik. Gjatë kësaj periudhe janë pranuar nga 4 komuna (*Hani i Elezit, Istogu dhe Podujeva, Drenas*) profilet ekonomike të komunave.

Sa i përket Hartimit të Programit Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2023-2029, është përgatit drafti final i PZHEL-së, i njëjti ka përfunduar fazën e konsultimit publik dhe paraparak i cili është dërguar në ZPS për opinionon dhe me datë 12.10.2023 është aprovuar në Qeveri me vendim nr.14/165.

Ndërsa, lidhur me përgatitjen e rekomandimeve për avancim të proceseve buxhetore komunale, është përgatitur shkresa me propozimet e MAPL-së dhe e njëjta i është dërguar zyrës së Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me propozimet nga MAPL lidhur me përcaktimin e financimit komunal nga Komisioni i Garantëve sipas LFPL dhe LMFP për finalizimin e KASH-it 2024-2026

- Është hartuar raporti i shpenzimeve të komunave për vitin 2022;
- Është hartuar raporti i të hyrave vetanake të komunave për vitin 2022;
- Është hartuar raporti lidhur me opinionet e auditimit për komunat e Republikës së Kosovës për vitin 2022 dhe krahasimi me vitin 2021

1.2. Financimi i projekteve të komunave

Programet për financimin e projekteve kapitale të komunave janë një ndër instrumentet kryesore të mbështetjes direkte të komunave në fushën e zhvillimit ekonomik. MAPL ka përgatitur kriteret për financim të projekteve të komunave në fushën e bashkëpunimit ndërkomunal dhe projekte infrastrukturore . Thirrja për aplikim nga komunat për financim të projekteve është publikuar dhe në kuadër të kësaj thirrje janë pranuar 26 aplikime nga 18 komuna, më pas është finalizuar raporti përfundimtar i vlerësimeve të aplikacioneve nga komisioni vlerësues dhe janë njoftuar komunat përfituese. Gjatë kësaj periudhe janë nënshkruar 13 Marrëveshje të Mirëkuptimit për financim të projekteve në 13 komuna (*Hani i Elezit, Lipjan, Malishevë, Gjakovë, Kamenicë, Suharekë, Podujevë, Rahovec, Deçan, Gjilan, Fushë Kosovë, Shtime, Pejë*). Pas nënshkrimit të Marrëveshjeve për financim të projekteve dhe pas aprovimit nga Qeveria, janë bërë zotimet e mjeteve. Nga 13 projektet, 8 komuna kanë filluar me procedura të prokurimit dhe për 2 projekte janë nënshkruar kontratat, 5 projekte janë në vlerësim dhe 1 projekt në tenderim. Sipas progresit të punimeve vazhdon monitorimi i projekteve. Janë realizuar takimet teknike me 13 komuna (*Gjilan, Fushë Kosovë, Deçan, Gjakovë, Rahovec, Lipjan, Hani të Elezit, Podujevë, Pejë, Shtime, Kamenicë,*

Subarekë dhe Malishevë). Pas nënshkrimit të kontratave nga komunat me operatorët ekonomik, vizitat në terren dhe verifikimi i punimeve të projekteve janë realizuar sipas situatave të pranura për punët e kryera për 12 projekte.

Sa i përket *programit për mbështetje për projektet infrastrukturore për komunitete* në komuna janë përgatitur kriteret për financim të projekteve, janë pranuar 38 aplikime nga 16 komuna më pas është finalizuar raporti përfundimtar i vlerësimeve të aplikacioneve nga komisioni vlerësues dhe janë njoftuar komunat përfituese. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë nënshkruar 18 marrëveshje të mirëkuptimit në mes të MAPL-së dhe komunave, me 10 komuna përfituese. Pas nënshkrimit të Marrëveshjeve të Mirëkuptimit, nga 18 projektet, komunat kanë filluar me procedura të prokurimit, ku janë nënshkruar 3 kontrata, 5 projekte në tender dhe 1 projekt në ritender. Sipas progresit të punimeve vazhdon monitorimi i projekteve. Është bërë zotimi i mjeteve për financimin e projekteve. Janë realizuar takimet teknike me komunat përfituese: *Klinë, Deçan, Gjakovë, Rahovec, Prizren, Istog, Pejë, Novobërdë, Graçanicë dhe Mamushë*. Pas nënshkrimit të kontratave nga komunat me operatorët ekonomik, vizitat në terren janë realizuar sipas situatave të pranura për punët e kryera për 10 projekte.

Në kuadër të bashkëfinancimit me donator për skemën e granteve bazuar në performancën komunale, në bashkëpunim me Departamentin për Performancë Komunale janë koordinuar aktivitetet me komuna lidhur me materialet e nevojshme për aplikimin e projekteve për Garantinë e Performancës Komunale. Janë përgatitur dhe janë përcjell dokumentet për opinion financiar në MFPT dhe janë aprovuar me vendim të Qeverisë Nr.12/138 të datës 12.4.2023. Janë zotuar mjetet për 14 projekte në 6 komuna përfituese. Janë realizuar takimet teknike me komunat: *Gjakovë, Klinë, Lipjan, Drenas dhe Obiliq*. Pas nënshkrimit të kontratave nga komunat me operatorët ekonomik, janë realizuar vizitat në terren për 13 projekte në komunën e *Klinës, Lipjanit, Drenas, Viti, Obiliqit dhe Gjakovës*. Janë proceduar lëndët për pagesë për 13 projekte të financuara në 6 komuna përfituese.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor, me kërkesë të auditorëve të jashtëm është koordinuar ekzaminimi fizik i 3 projekteve të financuara në komunën e Obiliqit për vitin 2022 dhe janë zhvilluar takime me auditor të jashtëm lidhur me procesin e menaxhimit të projekteve. Gjithashtu është realizuar takimi në bashkëpunim me OSCE për diskutimin me menaxheret për implementim të projekteve me bashkëfinancim me MAPL nga menaxherët e kontratave të Komunave për vitin 2023.

- Është hartuar raporti vjetor i investimeve kapitale për projekte për vitin 2022;
- Është hartuar raporti përmbljedhës i investimeve kapitale (2008 - 2022) i investimeve kapitale;
- Është hartuar raporti i tri viteve të fundit (2020 - 2022) i investimeve kapitale

1.3. Vlerësimi i performancës komunale

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal gjatë kësaj periudhe, rëndësi të madhe i ka kushtuar avancimit të sistemit të performancës komunale dhe skemës së grantit të bazuar në performancë. MAPL, ka dërguar lënda në MFPT për opinion financiar, është pranuar opinionin financiar, dhe me datë, 12.04.2023 lënda e kompletuar është aprovuar nga Qeveria. Nga ky grant janë financuar gjithsej 14 projekte nga investimet kapitale në komuna, përfituese të grantit kanë qenë 6 komuna sipas kriterëve të përfitimit të grantit. Në pjesën e parë të vitit 2023, janë mbajtur trajnimet për përdorimin e Sistemit Elektronik të SMPK, për të gjithë zyrtarët komunal të fushave të cilët janë pjesë e Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale

Sa i përket matjes së performancës së komuanve për periudhën Janar-Dhjetor 2023, divizioni përkatës ka bërë pranimin dhe vlerësimin e të dhënave nga Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK), gjithashtu ka trajtuar procesin e verifikimit paraprak në SMPK duke eliminuar gabimet eventuale teknike/logjike dhe ka

verifikuar të dhënat në procesin e verifikimi në SMPK, ku qëllimi kryesor i këtij rishikimi është azhurnimi i sistemit karshi reflektimit të ndryshimeve në kornizën ligjore në fushat e kompetencave komunale, përfshirë Udhëzimin Administrativ të rishikuar/aprovuar si dhe adresimi i mangësive të sistemit të paraqitur nga palët e interesit. Komisioni i ankesave ka shqyrtuar ankesat e komunave lidhur me vlerësimin e të dhënave komunale për vitin 2022 të cilat janë raportuar në SMPK.

Në kuadër të vlerësimit të komunave për grantin e performancës, janë themeluar grupet punuese për vlerësimin e Grantit të Performancës. Ndërsa në proces është vlerësimi sipas indikatorëve të GPK-së dhe hartimi i raportit për ndarjen e granteve.

Në periudhën Janar-Dhjetor 2023 është hapur thirrja për raportim nga komunat lidhur me matjen e performancës për vitin 2022, i cili raport është përfunduar dhe publikuar në ëeb faqën e MAPL-së.

II. Avancimi i bashkëpunimit ndërkomunal, komunal ndërkombëtar dhe ndërkufitar

Aktivitetet në këtë objektiv janë realizuar në drejtim të:

- Forcimit të bashkëpunimit ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar;
- Zbatimit të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar;

2.1. Bashkëpunimi ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar

Gjatë kësaj periudhe, MAPL ka vazhduar aktivitetet lidhur me mbështetjen e komunave për bashkëpunim ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtarë, për vitin 2023. Kanë vazhduar aktivitetet me donatorët, respektivisht me OSBE-në lidhur me realizimin e aktiviteteve të përbashkëta për vitin 2023.

Në kuadër të ***bashkëpunimit ndërkomunal***, gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjithsejtë shtatë (7) iniciativa/nisma për bashkëpunim ndërkomunal, janë nënshkruar gjithsej tre (3) Marrëveshje të Bashkëpunimit ndërkomunal dhe gjatë tërë vitit janë realizuar dhe kanë vazhduar aktivitetet e përbashkëta me donatorët respektivisht me OSBE-në lidhur me realizimin e aktiviteteve të përbashkëta për vitin 2023.

Lidhur me objektiven monitorimi, vlerësimi dhe raportimi për fushën e bashkëpunimit ndërkomunal, është vlerësuar ligjshmëria për gjashtë (6) marrëveshje të bashkëpunimit ndërkomunal. Është përgatitur raporti vjetor për Iniciativat dhe Marrëveshjet e Bashkëpunimit Ndërkomunal për Komunat e Republikës së Kosovës si dhe është organizuar trajnimi dy (2) ditor për zyrtarët komunal për temat: *Partneriteti Publiko Privat si formë e BNK, mbrojtja e ambientit përmes BNK-së, organizimi i transportit publik përmes BNK-së*.

Ngritja e kapaciteteve në komuna përmes trajnimeve dhe shkëmbimit të përvojave në fushën e bashkëpunimit ndërkomunal është realizuar me sukses në disa komuna të Republikës së Kosovës, për çka janë organizuar trajnime për nivelin komunal për temat: *Partneriteti Publiko Privat si formë e BNK, mbrojtja e ambientit përmes BNK-së, organizimi i transportit publik përmes BNK-së*.

Sa i përket bashkëpunimit komunal ndërkombëtarë, gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjithsejtë nëntë (9) iniciativa/nisma për bashkëpunim ndërkombëtar, janë nënshkruar (6) marrëveshje të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, është bërë vlerësimi i gjashtë (6) Marrëveshjeve të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar si dhe është përgatitur raporti vjetor për Iniciativat dhe Marrëveshjet e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar për Komunat e Republikës së Kosovës.

2.2. Zbatimi i programeve të bashkëpunimit ndërkufitar

Ka vazhduar avancimi i bashkëpunimit ndërkufitar në kuadër të tri programeve: Kosovë – Shqipëri, Kosovë – Maqedoni Veriore dhe Kosovë – Mali i Zi, në kuadër të IPA II, 2014 - 2022.

2.2.1. Programi IPA II Kosovë-Shqipëri 2014-2020

Në kuadër të Programit IPA II Kosovë-Shqipëri 2014-2020, ka vazhduar zbatimi dhe monitorimi i projekteve ndërkufitar si:

- “*Pathway towards an efficient use of local natural resources*”, në kohëzgjatje 30 muaj (prill 2022 -tetor 2024), në Bashkinë e Kurbinit dhe komunën e Suharekës në vlerë totale prej 420,167.00 €. Për këtë projekt janë realizuar vizita monitoruese tek projekti sipas planit të vizitave monitoruese të dakorduar me Strukturën Operative të Shqipërisë dhe Delegacionit të BE-se në Tiranë.
- “*Enhancement of Biodiversity in Drini River Basin through Integrated watershed Management – BIODRINI*” i zbatuar nga muaji shkurt 2022 në kohëzgjatje 24 muaj në Bashkinë e Kukësit dhe komunën e Rahovecit në vlerë totale prej 462,104.50 € në mënyrë që të shfrytëzohen më mirë potencialet e tyre turistike në ndjekjen e zhvillimit rajonal dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndërkufitar duke promovuar rrugët eko-turizmit në të dyja zonat si korridore natyrore dhe kulturore. Për këtë projekt janë realizuar vizita monitoruese tek përfituesit e thirrjes së tretë. Poashtu janë pranuar informata lidhur me projektin nga Sekretariati i Përbashkët Teknik (SPT).
- “*Eco - Tourism Routes in the Cross-Border Area for the Promotion of Alternative Tourism (ECO-ROUTES)*” i zbatuar nga muaji mars 2022 në kohëzgjatje 24 muaj në Bashkinë e Kukësit dhe komunën e Rahovecit në vlerë totale prej 470,482.00 €, në mënyrë që të shfrytëzohen më mirë potencialet e tyre turistike në ndjekjen e zhvillimit rajonal dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndërkufitar duke promovuar rrugët eko-turizmit në të dyja zonat si korridore natyrore dhe kulturore. Janë realizuar vizita monitoruese tek përfituesit e thirrjes së tretë në Tiranë. Poashtu janë pranuar informata lidhur me projektin nga SPT.
- “*Bridging Tourism through Cultural Heritage and Smart Solutions in Lezha and Gjakova*” i zbatuar nga muaji prill 2022 në kohëzgjatje 30 muaj në Bashkinë e Lezhës dhe komunën e Gjakovës në vlerë totale prej 453,245.00 Euro me bashkëfinancim (385,258.00 EUR nga fondet IPA) në kuadër të thirrjes së tretë me tematikën lidhur me inkurajimin e turizmit dhe promovimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Për këtë projekt janë realizuar vizita monitoruese tek projekti i thirrjes së tretë në Lezhë, po ashtu janë pranuar informata lidhur me projektin nga SPT.

Për menaxhim të Kontratës së Grantit për Asistencë Teknike dhe organizimit të takimeve të përbashkëta në kuadër të programit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 janë zhvilluar aktivitetet si: *është mbajtur një takim online i Komitetit të përbashkët monitorues; Janë mbajtur takimet bilaterale të Strukturave Operative të programit dhe JTS; është dorëzuar raporti narrativ dhe financiar në Delegacionin e BE-së në Tiranë dhe jemi në pritje të kështit të radhës; është mbajtur forumi rajonal i organizuar nga CBIB+ në Strugë; është realizuar vizita studimore në Agjencinë për Zhvillim, Kobezion dhe Bashkëpunim Territorial të Ministrisë së Planifikimit në Lisbon, Portugali; është realizuar event i për promovimin e programit me datë 25 shtator 2023, në qytetin e Bajram Currit, Shqipëri; Janë mbajtur 4 vizita monitoruese tek projektet e thirrjes së dytë dhe tretë; është dërguar tek SO AL dhe JTS raporti financiar për shpenzimet e realizuara deri në dhjetor 2023;*

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor, delegacioni i BE-së ka shpallur Thirrjen e 4-të për projekt propozime më 20 Shkurt 2023 dhe thirrja ka qenë e hapur deri më 22 Maj 2023. Janë realizuar dy sesione informuese për aplikantët potencial në zonë e programit (Lezhë, Shqipëri dhe Rahovec, Kosovë). Është në proces kontraktimi i projekteve të thirrjes së katërt me alokimet financiare 2019 dhe 2020 nga delegacioni i BE-së.

Sa i përket zbatimit të pakos për përfituesit e përzgjedhur të Thirrjes së Tretë për Propozime, janë realizuar trajnime mbi prokurimin sekondar, vizibilitetin dhe raportimin. Në kuadër të kontraktimit të projekteve të thirrjes së katërt me alokimet financiare 2019 dhe 2020, janë kontraktuar dy projekt propozime nga delegacioni i BE-së, nga thirrja e katërt me vlerë rreth 2,280,000.00 euro;

Gjate kësaj periudhe, është hartuar Raporti Vjetor i Implementimit (AIR) për vitin 2022, dhe Plani i Punës për vitin 2023 së bashku me Planin e Komunikimit dhe vizibilitetit për 2023 dhe janë miratuar në takimin e JMC. Kurse Programet e IPA III 2022 - 2027 janë aprovuar dhe janë publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Evropian, është themeluar Komiteti i Përbashkët Monitorues (JMC) për IPA III; dhe është përgatitur draft asistencë teknike 3 vjeçare për IPA III në bashkëpunim me OS të Shqipërisë, dhe është dorëzuar në delegacionin e BE-së në Tiranë për aprovim.

2.2.2. Programi IPA II Kosovë-Maqedoni Veriore 2014-2020

Në kuadër të Programit IPA II BNK Kosovë-Maqedoni 2014-2020 – ka vazhduar zbatimi dhe monitorimi i projekteve ndërkufitare, në kuadër të thirrjes së IV-të si:

- *“Pilot interventions for wastewater treatment and solid waste management in the cross-border region”* NovoBërdë – Gjorgje Petrov, në kuadër të këtij projekti është realizuar vizita monitoruese tek projekti gjatë muajit Maj, Qershor dhe gjatë muaji Gusht 2023 nga struktura operative e Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe stafit të Sekretariatit të Përbashkët Teknik lidhur me progresin e projekteve dhe sipas planit të vizitave monitoruese. Gjithashtu është përgatitur raporti i monitorimit të projekteve nga stafi i SPT. Ka përfunduar zbatimin i projektit të kontraktuar nga thirrja e katërt për projekt propozime.
- *“CBCEcoKid”*; Ferizaj – Çairi, në kuadër të këtij projekti është realizuar vizita monitoruese tek projekti gjatë muajit Maj, Qershor dhe Gusht 2023 nga struktura operative e Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe stafit të Sekretariatit të Përbashkët Teknik lidhur me progresin e projekteve dhe sipas planit të vizitave monitoruese. Gjithashtu është përgatitur raporti i monitorimit të projekteve nga stafi i SPT. Ka përfunduar zbatimin i projektit të kontraktuar nga thirrja e katërt për projekt propozime.
- *“Reviving crafts and building culture for joint touristic development”*, Prizren – Tetovë – është duke vazhduar zbatimin i këtij projekti. Është realizuar vizita monitoruese tek projekti gjatë muajit gusht 2023 nga struktura operative e Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe stafit të Sekretariatit të Përbashkët Teknik lidhur me progresin e projekteve dhe sipas planit të vizitave monitoruese. Gjithashtu është përgatitur raporti i monitorimit të projekteve nga stafi i SPT. Ka vazhduar zbatimin i projektit të kontraktuar nga Thirrja e katërt për projekt propozime deri në shtator 2024.

Për zbatimin e pakos implementuese për përfituesit e përzgjedhur të thirrjes së katërt për projekt propozime, është mbajtur trajnimi për raportim për përfituesit ndërsa për kontraktimin dhe zbatimin e projekteve nga thirrja e pestë për projekt propozime janë kontraktuar tri projekte në kuadër të thirrjes së pestë për propozime në vlerën totale prej rreth 1.71 milion Euro me bashkëfinancim, si: A Smart System for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenec River Basin; “Bridging regions” Be clean - be green.

Për menaxhim të Kontratës së Grantit për Asistencë Teknike dhe organizimit të takimeve të përbashkëta në kuadër të programit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 janë zhvilluar aktivitetet si: *12 takime të Komitetit të Përbashkët të Monitorimit (JMC) si dhe trajnim për anëtarët e Komitetit dhe strukturës operative nga dy vendet, janë mbajtur 4 takime bilaterale në mes të dy strukturave operative dhe Sekretariatit të Përbashkët Teknik në Shkup, është dërguar tek Zyra e BE-së raporti i tretë interim për periudhën 6 Janar 2022 - 5 Janar 2023 lidhur me Grant Kontratën (2019/410-322), kanë filluar procedurat për përgatitjen e asistencës së re teknike, është miratuar raporti financiar për vitin 2022, është ofruar mbështetje e vazhdueshme për përfituesit e projekteve si dhe raportimi i indikatorëve në databazën regjionale.*

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është mbajtur trajnimi për përfituesit e thirrjes së IV-të, është hartuar dhe aprovuar Raporti Vjetor i Implementimit (AIR) për vitin 2022, dhe Plani i Punës për vitin 2023 së bashku me Planin e Komunikimit.

Kurse sa i përket Programeve të IPA III 2022 - 2027, janë aprovuar dhe janë publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Evropian. Është themeluar Komiteti Drejtues i Programit (JMC) për IPA III. Është hartuar asistencë teknike 3 vjeçare për IPA III dhe është nënshkruar Grant kontrata në mes të MAPL dhe Zyrës së BE-së.

2.2.3. Programi IPA II Kosovë-Mali i Zi 2014-2020

Në kuadër të Programit IPA II BNK Kosovë-Mali i Zi 2014-2020 – gjatë kësaj periudhe ka vazhduar zbatimi i projekteve ndërkufitare të Thirrjes së dytë si:

- *"Krijimi i punësimit në Bujqësi" Podgoricë, Tuz dhe Istog, Pejë*, ky projekt ka përfunduar aktivitetet, me që rast me datë 27 qershor 2023 është mbajtur konferenca përmbyllëse. Projekti ka ndikuar në rritjen e qasjes në tregun e punës dhe përfundimin e kapacitetit të grave, të rinjve dhe të papunësuarave për të gjeneruar të ardhura nga bujqësia. Janë përmirësuar gjithashtu kapacitetet e grupeve të synuara përmes aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve, praktikave, mentorimit, si dhe sigurimit të pajisjeve të nevojshme për bujqësi dhe lehtësimin e rrjetëzimit me blerësit e produkteve bujqësore. Zbatimi i projektit është zgjatur pa kosto shtesë dhe pritet të përfundojë vitin e ardhshëm.
- *"Veprime ndërkufitare për sektorin e riprodhimit shëndetësor"*, ky projekt është duke u zbatuar me sukses, duke kontribuar në përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve shëndetësore publike si dhe cilësinë e shërbimeve të shëndetit riprodhues në rajonin ndërkufitar. Vizita e tretë monitoruese është mbajtur më 15 qershor 2023.
- *"Qendra turistike për një ofertë më të mirë turistike në vendet më pak të avancuara malore" Andrijevica (Mali i Zi) dhe Deçan (Kosovë)*. Ka vazhduar zbatimi i projektit, vizita e tretë monitoruese është mbajtur tek lideri i projektit në Andrijevica më 3 korrik ndërsa në komunën e Deçanit më 4 korrik 2023 për të parë progresin e arritur. Përmes këtij projekti, një kasolle e re malore është ndërtuar në Bjeshkët e Nemuna në Deçan, ndërsa kasollja ekzistuese në Krivi Do në Andrijevicë është riparuar dhe pajisur. Përveç kësaj, projekti ka përfshirë një ofertë shtesë turistike rreth këtyre dy qendrave, të cilat do të përfshijnë katunet lokale. Projekti është zgjatur pa kosto shtesë dhe pritet të përfundojë në tre mujorin e parë të vitit 2024;

Për menaxhimin e TAGC dhe organizimit të takimeve të përbashkëta në kuadër të Programit janë zhvilluar aktivitetet si: *është mbajtur takimi i Komitetit të Përbashkët të Monitorimit, është mbajtur takimi bilateral në mes strukturës operative të Kosovës dhe Malit të Zi, është mbajtur trajnimi për prokurim sekondar për stafin e BNK-së dhe trupës kontrolluese në Podgoricë, është mbajtur trajnimi nga Interact për stafin e BNK-së dhe JTS "Communication under IPA CBC - Storytelling, është mbajtur punëtorja me gazetarë në kuadër të promovimit të programit të BNK-së në zonat e programit që ka përfshirë vizitat tek projektet e thirrjes së I dhe II-të në Deçan, Klinë, Gjakovë dhe Pejë, është mbajtur takimi i Komitetit të Përbashkët Drejtues ku është miratuar raporti narrativ dhe financiar dhjetor 2021 - prill 2023; janë mbajtur vizitat monitoruese tek tri projekte të thirrjes së dytë, janë mbajtur vizitat e para monitoruese tek 11 projektet e thirrjes së tretë gjatë muajit shtator, janë mbajtur takime bilaterale në mes të dy SO-ve, CFCU, DEU dhe JTS dhe janë hartuar raporte mujore nga Sekretariati i Përbashkët Teknik për zbatim të TAGC; Është hartuar garancia e vjetor menaxhues, i plotësuar dhe dërguar nga udhëheqësi i SO KS&BNK-së; Është mbajtur takimi i parë i JMC për IPA III më 20 dhjetor 2023*

Lidhur me kontraktimin e projekteve të thirrjes së tretë, janë kontraktuar 11 projekte në kuadër të thirrjes së III-të dhe është mbajtur ceremonia për ndarjen e granteve/zyrtarizmin e kontraktimit të projekteve të thirrjes së III-të më 17 mars 2023 në Pejë. Për pakon implementuese për projektet e thirrjes së tretë, janë mbajtur trajnimet për përfituesit e thirrjes.

Gjate kësaj periudhe, është hartuar Raporti Vjetor i Implementimit (AIR) për vitin 2022, dhe Plani i Punës për vitin 2023 së bashku me Planin e Komunikimit dhe vizibilitetit për 2023 dhe janë miratuar në takimin e JMC. Kurse sa i përket Programeve të IPA III 2021 - 2027, janë aprovuar dhe janë publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Evropian dhe është në proces themelimi i JMC-së për IPA III. Marrëveshja Financiare për IPA III për periudhën 2021-2027 është ratifikuar dhe shpallur në Gazetën Zyrtare më 13.10.2023. Është themeluar JMC për IPA III i përbërë nga anëtarë/zëvendësues të Strukturave Operative të BNK-së, ministrive të linjës, shoqërisë civile si dhe zyrës së BE-së në Kosovë/Delegacionit të BE-së në Mal të Zi në cilësi të vëzhguesve.

2.3.4 Kontrolli i programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar

Për kontrollin dhe verifikimin financiar të fondeve të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar, në përputhje me rregullat dhe standardet e BE-së dhe ligjet e aplikueshme vendore është përgatitur dhe aprovuar plani vjetor i vizitave on the spot check, dhe e njëjta është ndarë me Drejtorinë për Financa dhe Kontraktim të Fondeve të BE-së në Ministrinë e Financave të Malit të Zi (CFCU/MNE). Janë realizuar 4 vizita në teren të projekteve: CFCU/MNE 148, CFCU/MNE 152, CFCU/MNE 149 dhe CFCU/MNE 151, janë pranuar të gjitha kontratat e përfituesve nga thirrja e III (tretë) për propozime. Është përfunduar raporti përfundimtar i verifikimit CFCU/MNE 152. Kurse në vazhdimësi janë raportet e projekteve: CFCU/MNE 150, dhe CFCU/MNE 148; CFCU/MNE 149; CFCU/MNE 147.

Është përgatitur letra konfirmuese për Autoritetin Kontraktues lidhur me shpenzimet e pranueshme dhe jo të pranueshme nga përfituesit e thirrjes së dytë CFCU/MNE 149; CFCU/MNE 152. CFCU/MNE 151. Në këtë periudhë raportuese janë realizuar 12 vizita në terren të projekteve të thirrjes së dytë dhe të tretë.

Gjithashtu është hartuar garancioni vjetor për trupën kontrolluese për vitin 2023 dhe janë arkivuar dhe mirëmbajtur të gjitha dokumentet e pranuar nga përfituesit e thirrjes së dytë, në kuadër të rregullave të parapara.

III. Avancimi i politikave dhe i kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale

Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe që ndërlidhen me përmbushjen e objektivit 2 të Planit të Punës për vitin 2023, janë shtrirë në drejtim të:

- Hartimit të projektligjeve dhe akteve nënligjore të planifikuara;
- Konsultimit paraprak të akteve sektoriale;
- Takimeve të rregullta me komunat;
- Monitorimit të komunave;
- Adresimin dhe zbatimin e obligimeve nga agjenda evropiane;
- Koordinimit të politikave;
- Raporteve të hartuara.

3.1. Zhvillimi i akteve ligjore dhe nënligjore

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, fokus të veçantë i ka dhënë edhe zhvillimit dhe avancimit të legjislacionit sipas programit legjislativ për vitin 2023 dhe dokumenteve tjera, të cilat janë në proces të hartimit dhe plotësimit/ndryshimit, si në vijim:

- Plotësim ndryshimi i Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunë – *ky projektligj është hartuar dhe është aprovuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës me vendimi Nr.09/180, të datës 27.12.2023.*
- Projekt Ligji për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave - *ky projektligj është hartuar dhe është aprovuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës.*
- Udhëzim Administrativ për emërimin e nënkryetarëve të komunave – *ky udhëzim administrativ është hartuar dhe është miratuar nga Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.*
- Udhëzimi Administrativ për administratën e hapur lokale - *ky udhëzim administrativ është hartuar dhe është miratuar nga Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.*
- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 01/2023 për Menaxhimin e Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për Performancë Komunale - *ky udhëzim administrativ është hartuar dhe është miratuar nga Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.*


- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 02/2023 Për Iniciativën E Qytetarëve Për Largimin E Kryetarit Të Komunës Nga Funkcioni - *ky udhëzim administrativ është hartuar dhe është miratuar nga Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.*
- Koncept Dokumenti për Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (*ky koncept dokumenti ka përfunduar dhe është miratuar nga Qeveria*)
- Vlerësimi Ex post i Mekanizmave ligjore për demokraci lokale - *është hartuar Raporti për vlerësimin ex-post mbi mekanizmat e demokracisë lokale. Raporti është aprovuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës me vendimin Nr.22/180 të datës 27.12.2023.*

3.2. Vlerësimi i ndikimit të politikave në fushën e vetëqeverisjes lokale

Sa i përket konsultimit paraprak të akteve të ministrive sektoriale dhe përputhshmërisë së tyre me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, është themeluar Grupi Punues brenda ministrisë i cili është përgjegjës për shqyrtimin e akteve për konsultim paraprak, i cili në vazhdimësi pranon akte nga ministrinë e linjës për konsultim paraprak. Ndërsa, lidhur me shkresat njoftuese që adresohen në komuna, në këtë periudhë kohore janë pranuar janë 15 kërkesa për konsultim paraprak, janë pranuar dhe shqyrtuar 274 kërkesa dhe 56 ankesa nga personat fizik dhe juridik.

3.3. Monitorimi i kuvendeve të komunave

Në periudhën Janar – Dhjetor 2023, kanë funksionuar kuvendet në 38 komuna të Republikës së Kosovës, duke mbajtur mbledhje rregullisht. Kuvendet e komunave kanë mbajtur 461 mbledhje. Mbledhjet e kuvendeve të komunave janë monitoruar përmes sistemit të teleprezencës, si dhe prezencës fizike të zyrtarëve për komunat: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq. Gjatë kësaj periudhe janë pranuar gjithsej 2010 akte, prej tyre 109 rregullore dhe 1921 vendime të kuvendeve të komunave. Nga gjithsej 2010 akte, MAPL ka vlerësuar 1105 akte, përderisa 905 akte të tjera janë dërguar në Ministrinë e linjës. Janë konstatuar 120 akte të kundërligjshme, prej të cilave janë rishqyrtuar 110 akte, ndërsa 4 akte janë dërguar në Ministrinë e Drejtësisë.



Diagrami 1: Numri i mbledhjeve të komunave dhe aktet e shqyrtuara gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal konform mandatit ligjor të përcaktuar me legjislacionin për vetëqeverisje lokale monitoron komunat mbi bazën e të cilave harton raporte periodike për funksionimin e

komunave të Republikës së Kosovës. Komunitet, përkatësisht organet e komunës janë të obliguara që ushtrimin e kompetencave të tyre ta zhvillojnë sipas Kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore të Republikës së Kosovës. Gjatë kësaj periudhe kanë funksionuar Kuvendet e 38 komunave, bazuar në nenin 86 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. MAPL është e obliguar të hartoj dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend të Republikës së Kosovës, Raportin vjetor të funksionimit të komunave. Ky raport është dërguar në Qeveri, Presidencë dhe Kuvend në fund të muajit Mars 2023. Është hartuar raporti për vlerësim të ligjshmërisë për periudhën Janar-Qershor 2023, janë zhvilluar 12 vizita monitoruese në 12 komuna dhe është mbajtur një takim me kryesues të kuvendeve të komunave.

3.4. Adresimi i obligimeve nga agjenda evropiane

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka bërë koordinimin e aktiviteteve me komuna për adresimin dhe zbatimin e obligimeve të cilat burojnë nga agjenda e integritetit evropian. Në këtë periudhë kohore është hartuar Raporti i përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar-Dhjetor 2022 si dhe raporti gjashtëmujor i përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar-Qershor 2023. Bazuar në të dhënat e ofruar, gjatë vitit 2023 komunitet e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin 47% të aktiviteteve në fushën e kriterëve politike, 35% sa i përket kriterëve ekonomike, dhe në fushën e standardeve evropiane ato kanë realizuar 70% të aktiviteteve. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për vitin 2023 është 50%. Për prezantimin e këtij raport është mbajtur takimi me Zyrat Komunal për Integritet Evropian, gjithashtu gjatë kësaj periudhe është dërguar kërkesa në 38 komuna për raportin e obligimeve të përmbushjes së komunave nga agjenda evropiane për periudhën Janar-Dhjetor 2023.


Është përgatitur Raporti mbi Zbatimin e Programit Kombëtar të MSA-së për vitin 2022, dhe Raporti mbi Zbatimin e Planit të Veprimit të ERA II (PV ERA II) për vitin 2022. Gjithashtu, janë identifikuar dhe propozuar Obligimet e komunave dhe MAPL-së nga PKZMSA, dhe është përgatitur Inputi i MAPL-së për raportin e KE-së për periudhën 15 qershor 2022- 31 Mars 2023, Inputi i dytë për periudhën 1 Prill – 15 Qershor 2023 si dhe Inputi i MAPL-së për raportin e KE-së për periudhën 15 Qershor – 15 Gusht 2023. Janë përmbledhur të dhënat për raportin të MAPL-se lidhur me Nën komitetin për Drejtësi, Liri dhe Siguri. Janë identifikuar sfidat e qeverisjes lokale nga raportin i KE-së për Kosovën dhe është përgatit shkresa për Kryetarë të Komunave e cila është përcjell në 38 komuna. Janë hartuar raportet periodike të Programit kombëtar të MSA-së për periudhën Janar-Dhjetor 2023 dhe janë lansur në platform si dhe për të njëjtin dokument është pranuar nga Zyra e Kryeministrit kërkesa për rishikimi të Planit Kombëtar për Integritet për vitin 2024-2026 të cilat masa janë adresuar nga MAPL.

Në bashkëpunim me OSBE është mbajtur ceremonia e ndarjes së mirënjohjeve për komunitet të cilat kanë miratuar planin e integritetit, (sfidë e dalë nga Raporti i Vendi i KE). Gjithashtu janë mbajtur katër takime me misionin e OSBE-së në Kosovë dhe në bashkëpunim me OSBE është mbajtur këshillimi i përbashkët njëditorë me Zyrat Komunal për Integritet Evropian me qëllim të hartimit të planit gjithëpërfshirës të komunave për obligimet e agjendës evropiane për vitin 2023, i njëjti plan i hartuar është dërguar në 38 komuna për raportin për periudhën Janar-Qershor 2023. Në bashkëpunim me Departamentin e të Drejtave të Njeriut dhe Komuniteteve në OSBE janë koordinuar aktivitetet e përbashkët në fushën e të drejtave të njeriut dhe mundësia e mbështetjes për vitin 2024, gjithashtu janë mbajtur 3 takime me donatorë për mbështetjet e aktiviteteve të MAPL-së Është përgatitur udhëzuesi për komuna lidhur me avancimin e politikave lokale sipas sfidave të dala nga Raporti i Vendi.

3.5. Koordinimi i politikave

Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar takime me departamente dhe njësitë organizative të MAPL-së për koordinimin e aktiviteteve të planifikuara në vitin 2023 dhe ka përfunduar hartimi i planit vjetor të punës së MAPL-së për vitin 2023 i njëjti është publikuar edhe në kuadër të ueb faqes zyrtare të MAPL-së. Në këtë periudhë është bërë

identifikimi i prioriteteve afatmesme strategjike, është hartuar Plani Kombëtar për Zhvillim i MAPL-së, si dhe është bërë harmonizimi i tij me KASH. Është përgatitur raporti për periudhën Janar-Dhjetor 2023 lidhur me zbatimin e aktiviteteve të MAPL-së në kuadër të Programit Kombëtar për Zhvillim 2023-2025 si dhe janë rishikuar masat për Programin Kombëtar për Zhvillim për periudhën 2024-2026. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë hartuar edhe dokumente të tjera, si:



IV. Ngritja e transparencës komunale, promovimi i të drejtave të njeriut dhe zhvillimi i kapaciteteve

Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe (Janar – Dhjetor, 2023) janë ato të cilat ndërlidhen me:

- Monitorimin e fushës së të drejtave të njeriut në komuna;
- Informimi i publikut rreth aktiviteteve të MAPL-së;
- Transparenca dhe llogaridhënia;
- Ngritja e kapaciteteve komunale; dhe
- Bashkëpunimit me shoqërinë civile.

4.1. Aktivitetet në fushën e të drejtave të njeriut dhe transparencën komunale

MAPL ka vazhduar me mbështetjen e komunave në zbatimin e politikave në fushën e të drejtave të njeriut. Në këtë periudhë është hartuar Raporti vjetor për të drejtat e njeriut për vitin 2022. Raporti përfshinë segmentin e të drejtave të njeriut nga fusha e barazisë gjinore, funksionimi i njësisë për drejtat e njeriut në komuna, barazia gjinore, dhuna në familje, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e fëmijëve, mbrojtja nga diskriminimi, parandalimi i trafikimit me njerëz, të drejtat të komuniteteve dhe të drejtën gjuhësore në komunat e Republikës së Kosovës. Në këtë periudhë, gjithashtu, është hartuar metodologjia e punës për vizitat në komuna, pyetësori për të drejtat e njeriut, janë mbledhur të dhënat nga Njësia e të Drejtave të Njeriut në Komuna dhe janë zhvilluar vizita në dy komuna Mitrovicë Jugore dhe Vushtrri. Gjithashtu janë vizituar 11 komuna: *Pejë, Prizren, Gjakovë, Gjiilan, Ferizaj, Mitrovicë, Prishtinë, Kamenicë, Istog, Drenas dhe Klinë* për Promovimin e të Drejtave të Njeriut.

Për fushatën kundër trafikimit me njerëz në komuna, komunat janë njoftuar për hapjen e fushatës vetedijesuese për parandalimin e trafikimit me njerëz e cila fushatë është realizuar në 14 komuna: *Pejë, Prizren, Gjakovë, Gjiçan, Ferizaj, Mitrovicë, Prishtinë, Kamenicë, Istog, Glogoc, Podujevë, Malishevë, Vushtrri dhe Klinë*.

Është hartuar Analiza-Vlerësimi i kapaciteteve të strukturave dhe zyrtarëve komunal të mandatuara për të punuar me grupet e marginalizuara. Për prezantimin e kësaj analize MAPL në bashkëpunim me DEMOS ka organizuar takimin me kryetarë, nënkryetarë, zyrtarë të ZKKK-së dhe zyrtarë të NJDNJK-së me 24 komuna. Është hartuar matrica për monitorim të zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2022-2024.

Më qëllim të përmirësimit të të drejtave të fëmijëve në nivel të qeverisjes lokale, është punuar me komunat për funksionimin e mekanizmave për të drejtat e fëmijës sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, është mbajtur takimi parapërgatitor për themelimin e Mekanizmit Ndërinstitucional për Zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Menaxhimin dhe Kontrollin e Qenve me dhe pa Pronar në Republikën e Kosovës. Si dhe në bashkëpunim me Syri i Vizionit / Save the Children, është realizuar fushata për promovimin e ligjit për mbrojtjen e fëmijës në 10 komuna: *Pejë, Prizren, Gjakovë, Gjiçan, Ferizaj, Mitrovicë, Prishtinë, Kamenicë, Istog edhe Klinë*, ku gjatë kësaj periudhë kohore janë takuar mbi 136 anëtar të Ekipeve në komuna, janë shpërndarë mbi 7000 broshura për informimin e fëmijëve mbi ekzistimin e një mekanizmi të ri në komuna për të drejtat e fëmijës.

Është hartuar raporti për komunat në mbrojtje nga diskriminimi sipas indikatorëve të kornizës për periudhën Janar-Qershor 2023 dhe i njëjti është dërguar në ZQM/ZKM.

Gjatë kësaj periudhe është dërguar shkresa informuese tek të gjitha komunat e Republikës së Kosovës për t'i informuar rreth fillimit të fushatës për regjistrim falas të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Të gjitha komunat tashmë e kanë edhe qarkoren e lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin Civil të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila u rekomandon komunave, gjegjësisht zyrrave të gjendjes civile për heqjen e gjobave dhe tarifave të tjera për shërbimet e regjistrimit.

Për funksionalizimin e mekanizmave për të drejtat e fëmijës në nivel lokal sipas legjislacionit në fuqi, MAPL ka hartuar Udhëzimin Administrativë për themelimin dhe funksionimin e ekipi për drejtat e fëmijës. Më tutje MAPL në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Punës në Kosovë (ILO) kanë organizuar trajnime me katër grupe të ndara me anëtarë të ekipit për të drejtat e fëmijës për obligimet e komunave

Është hartuar raporti për transparencë të komunave për periudhën Janar- Dhjetor 2022 duke monitoruar të dhënat përmes ueb faqeve zyrtare të komunave dhe për prezantimin e këtij raporti është mbajtur një takim me zyrtarët e informimit në komuna. Ndërsa në mënyrë të rregullt është vazhduar me vlerësimin e transparencës komunale, përfshirë monitorimin e kuvendeve të komunave në aspektin e transparencës, monitorimin e ekzekutivit dhe llogaridhënia në aspektin e transparencës, monitorimin e transparencës buxhetore të komunave, dhe transparenca në prokurimin publik, monitorimi i takimeve publike me qytetarët dhe zbatimi i standardeve minimale të konsultimeve publike. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është mbajtur takimi me zyrtarët komunal me temën “*Sfidat nga Plani i Veprimit për Transparencë dhe Rregullorja për transparencë komunale*”. Në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit dhe me mbështetje të OSBE-së dhe IKAP, është organizuar Trajnimi “*Konsultimi publik në komuna dhe procesi i Publikimit në Platformën për Konsultime Publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës*”. Ka vazhduar bashkëpunimi me Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe Agjencinë për informim dhe privatësi në fushën e transparencës. Po ashtu në bashkëpunim me OSBE-në është organizuar takim me zyrtarët e informimit lidhur me procesin e MPLVT dhe Rregullores për transparencë në komuna dhe identifikimin e vështirësive në zbatimin e obligimeve ligjore. Në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe me zyrtarë të informimit është realizuar punëtoria “*Aktivizimi i qytetareve në planifikim, monitorim dhe vendimmarrje komunale dhe funksionimi dhe përgjegjësitë e zyrës së informimit*”.

4.2. Hartimi dhe miratimi i Planit Nacional të Veprimit 2023 - 2024 në kuadër Partneritetin për Qeverisje të Hapur - PQH

Në kuadër të qeverisjes së hapur si njëri nga parimet themelore të punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nismën e MAPL, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim që të fillohet me hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit 2023-2025 për qeverisje të hapur në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur – PQH. Planit Kombëtar i Veprimit 2023-2025 është hartuar dhe ka kaluar në dy proceset e konsultimit paraprak dhe konsultimit publik dhe është miratuar nga Qeveria. Republika e Kosovës ka tejkaluar të gjitha pengesat politike për anëtarësim në OGP dhe ka arritur të kalojë fazën e vlerësimit të kritereve minimale.

MAPL ka dorëzuar në organizatën Open Government Partnership, Letrën e Interesit ku paraqet vullnetin dhe interesimin e Republikës së Kosovës për të u anëtarësuar në këtë organizatë. Komiteti Nacional Koordinues ka miratuar plotësim ndryshimet e Planit Kombëtar të Veprimit 2023-2025 në kuadër të OGP-së dhe e ka dorëzuar në Open Government Partnership për komente. MAPL ka pranuar letrën zyrtare të anëtarësimit të Republikës së Kosovës nga Komiteti Mbikëqyrës i Open Government Partnership. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe delegacioni i Republikës së Kosovës ka marrë pjesë në Samitin Global të Open Government Partnership. Republika e Kosovës tashmë figuron në listën e anëtarëve të Open Government Partnership në ueb-faqen zyrtare të saj.

4.3. Zhvillimi i platformës shtetërore E-KOMUNAT

MAPL ka filluar procesin e digjitalizimit të shërbimeve komunale përmes zhvillimit të platformës E-KOMUNAT. Kjo platformë do të jetë në shërbim të qytetarëve për rritur pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje në nivelin lokal, dhe do të jetë në shërbim të vet komunave për digjitalizimin e shërbimeve komunale. Në kuadër të kësaj MAPL si udhëheqëse e këtij procesi gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar fazën e parë të platformës E-Komunat dhe pas lansimit të fazës së parë të platformës E-KOMUNA, MAPL është fokusuar në zhvillimin e fazës së dytë të kësaj platforme e cila është në zhvillim e sipër.

4.4. Informimi i publikut për aktivitetet e MAPL-së



Gjatë kësaj periudhe MAPL ka ofruar informata të vazhdueshme për publikun, mediat, shoqërinë civile, organizatat e huaja ndërkombëtare, si dhe palët e interesuara lidhur me aktivitetet e zhvilluara. Janë pranuar dhe aprovuar 46 kërkesa për Qasje në Dokumente Publike. Po ashtu në E-mail zyrtar të MAPL-së, janë pranuar 73 pyetje nga mediat, dhe janë kthyer 64 përgjigje nga MAPL-ja me ç'rast në pyetjet tjera Ministri i MAPL-së është përgjigjur në Konferencë për Media. Ministri i MAPL-së ka mbajtur 4 konferenca për media. Gjatë vitit 2023 janë dërguar 8 ftesa për media, dy (2) njoftime dhe tri (3) komunikata për media. Janë pranuar katër (4) kërkesa për informata

dhe janë kthyer katër (4) përgjigje nga MAPL-ja. Gjithashtu kemi pasur dy (2) pjesëmarrje në emisione televizive. Raporte ditore të pasqyrimin të mediave online përgjatë gjithë vitit janë përgatitur 250 raporte.

Në Web-faqen e MAPL-së gjatë kësaj periudhe janë publikuar si vijon: Në linkun Lajme janë publikuar 36 informata; në linkun aktivitetet ditore 17 informata; Në linkun Thirrje për Propozime janë publikuar 42 dokumente; Në linkun njoftime për Prokurim Publik është publikuar një (1) dokument; Në linkun Udhëzimet Administrative, janë publikuar 3 dokumente /udhëzime administrative. Në linkun Koncept dokumente është publikuar vetë një (1) dokument. Në linkun Vende të lira të punës janë publikuar 15 dokumente/Njoftime; Në

linkun Publikime janë publikuar 57 dokumente/Raporte; Në linkun Raportet vjetore të MAPL-së, janë publikuar 14 raporte/dokumente; Në linkun Planet vjetore të MAPL-së është publikuar 1 dokument; Në linkun Shqyrtimi i ligjshmërisë së Komunave janë publikuar 368 dokumente si dhe në linkun Ndërtimi dhe Renovimi i shtëpive për komunitetet jo-shumicë janë publikuar 19 dokumente. Në Web-faqe e MAPL-së janë shtuar dy (2) linqe të reja: Linku – Ndërtimi dhe Renovimi i Shtëpive për Komunitetet Jo-shumicë (janë publikuar 10 dokumente) dhe Linku – Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale. Në linkun Politikat dhe Strategjitë është krijuar një linku – Strategjia Kombëtare dhe plani i veprimit për menaxhimin dhe kontrullin e qenëve me dhe pa pronar në Republikën e Kosovës 2022-2028, në këtë link janë publikuar dy (2) dokumente.. Në faqen zyrtare të MAPL-së Facebook janë publikuar 36 informata të takimeve; tri (3) njoftime; një (1) ftesë; një (1) sqarim për media, dy (2) reagime dhe tri (3) Video- incizim.

4.6. Bashkëpunimi me shoqërinë civile

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka vazhduar me përfshirjen e shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe legjislacionit për vetëqeverisje lokale dhe në implementimin e strategjisë për vetëqeverisje lokale 2016-2026, ku gjatë kësaj periudhe në çdo grup themelues për hartimin e politikave dhe legjislacionin e ministrisë është përfshirë edhe nga një anëtarë i shoqërisë civile. Gjithashtu është mbajtur një takim i përbashkët me forumin konsultativ për qeverisje lokale.


4.7. Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunal

Në pajtim me objektivat e strategjisë për vetëqeverisje lokale, gjegjësisht forcimit të kapaciteteve institucionale të komunave, janë ndërmarrë veprime për zbatimin e aktiviteteve të parapara në këtë fushë. Në këtë drejtim, janë organizuar takime me IKAP dhe donatorë për të koordinuar aktivitetet rreth organizimit të trajnimeve për komuna konform planit të trajnimeve dhe për të ofruar përkrahje në realizimin e planit të trajnimeve dhe vlerësimin e nevojave për trajnime. Në gjashtëmujorin e parë në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP), Ministrin e Mjedisit për Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI), Agjencinë Japoneze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (JICA), OSBE, INDEP-GIZ dhe DEMOS janë realizuar tetë (8) sesione trajnimesh për fushat gjegjëse dhe gjithsej janë trajnuar 380 zyrtar komunal në fushat si në vijim: *Ngritje e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave drejt një shoqërie të shëndoshë (Faza II), Strategjia për zhvillim ekonomik lokal, Rritja e komunikimit me media dhe marrëdhëniet me publikun dhe menaxhimin e mediave sociale, Funksionimi i Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale, trajnim në fushën e të drejtave të njeriut (Udhëzimit administrativ (QRK) nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës), “Konsultimi publik në komuna dhe procesi i Publikimit në Platformën për Konsultime Publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës”.*

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është përgatitur Raporti i Vlerësimit të nevojave për trajnime për vitin 2024 bazuar në përgjigjet e marra nga pyetësi i dërguar tek zyrtarët komunal në Komuna.

V. Administrata, financat, auditimi dhe prokurimi

5.1. Administrata dhe financat



Për hartimin e planit të rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2023, është bërë mbledhja e informatave lidhur me kohën e paraparë për zotimin dhe shpenzimin e mjeteve, ky plan është dorëzuar në Ministrinë e Financave përmes sistemit të SIMFK-së. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është përcjell rrjedha e alokimit të mjeteve dhe janë bërë ndryshime për planin e shpenzimeve. Sa i përket raportit vjetor financiar për vitin e përfunduar 2022, është dorëzuar në MFPT dhe gjithashtu janë kryer të gjitha regjistrimet e pasurisë dhe stoqeve. Për sigurimin e kodeve për projektet kapitale, janë përgatitur dhe dorëzuar kërkesat dhe fletalokimi për MFPT, janë kompletuar lëndet me MeM dhe PIP dhe janë alokuar mjetet për projektet e reja. Është përgatitur dhe dorëzuar Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026. Sa i përket kërkesave buxhetore për vitin 2024, pas pranimi të Qarkores buxhetore për vitet 2024-2026 janë identifikuar nevojat buxhetore dhe është dorëzuar kërkesa buxhetore. Është përgatitur hartimi i Programit të Investimeve Publike (PIP) në bazë të qarkores së parë buxhetore, janë përgatitur dhe janë vendosur në

sistemin BDMS shpenzimet në bazë të qarkores së parë buxhetore.

Gjatë kësaj periudhe është përgatit: 1) Raporti për listën e rreziqeve për periudhën janar -dhjetor 2022 si dhe për periudhën janar-dhjetor 2023, 2) Raporti i listës së vetëvlerësimit për vitin 2022. Për zotime, pranim të mallit, shpenzim dhe çertifikim të lëndëve për pagesa janë pranuar kërkesat inicuese për zotimin e mjeteve në SIMFK, janë pranuar lëndët dhe faturat për procedim të pagesave dhe janë evidentuar në librin e protokollit, është bërë përgatitja CPO-së dhe është kryer regjistrimi i zotimeve, shpenzimeve dhe çertifikimi në SIMFK, është kryer pranimi i mallit në SIMFK dhe evidentimi në librin e protokollit intern, është bërë skanimi i lëndëve, arkivimi elektronik në Share Folder si dhe arkivimi fizik i lëndëve.

Gjatë kësaj periudhe është bërë raportimi, barazimi i raportit të SIMFK dhe analizimi i tij me raportet e shpenzimeve për periudhën Janar - Dhjetor 2022 dhe në baza mujore për periudhën janar - nëntor 2023. Ndërsa sa i përket objektivit Parasë së imte (Patty Cash) dhe Avanseve për udhëtime zyrtare, është bërë hapja e petty cashit për administratë dhe për kabinet, është bërë përgatitja e fletëpranimit standard të parasë së imtë dhe vendosja e të dhënave në çarshaf për kërkesat e bërë për Petty Cash, është bërë përgatitja e formularëve dhe llogaritja e shpenzimeve para dhe pas kthimit të zyrtarëve nga vizita zyrtare, është bërë tërheqja e parave të gatshme nga banka komerciale dhe kthimi i mjeteve në rastet kur ka pasur kthim të mjeteve dhe është bërë mbyllja e Kredit Karteleve në rastet kur ka pasur shpenzime.

Për raportimin e obligimeve të papaguara dhe obligimeve kontraktuale në vazhdimësi janë përgatitur dhe dorëzuar raportet mujore për faturat e papaguara dhe obligimeve kontraktuale. Ndërsa për hartimin e raporteve mujore financiare dhe raporteve tjera mbi shpenzimet e përgjithshme, janë përgatitur raportet javor për buxhetin e përgjithshëm për MAPL-në zotimi, shpenzimi dhe çertifikimi. Janë hartuar raportet e kontabilitetit mbi shpenzimet e përgjithshme, janë dorëzuar raportet javore të buxhetit dhe në vazhdimësi janë kontrolluar lëvizjet buxhetore. Për menaxhimin e pasurisë së MAPL—së gjatë kësaj periudhe është kryer: *regjistrimi i pasurisë mbi 1,000.00 € në SIMFK, regjistrimi i pasurisë në sistemin e-pasuria dhe bartja e investimeve kapitale në komuna pas përfundimi të projekteve.*

Është përgatitur dhe dorëzuar Raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit Gjeneral, si dhe plani i veprimit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike sipas vendimit të qeverisë.

Buxheti i MAPL-së për vitin 2023, (bazuar në raport të datës 26.01.2024 për vitin 2023) së bashku me Donacionin (93 Council of Europe dhe WB-Banka Botërore) është 12,934,069.15 €. Nga kjo shumë për periudhën Janar – Dhjetor nga buxheti i konsoliduar janë shpenzuar 7,349,725.79 € ose 67.29 % e buxhetit. Prej kategorisë së donacionit 93 Council of Europe është shpenzuar shuma 117,441.48 € ose 42.06 % e buxhetit ndërsa nga donacioni EB-Banka Botërore është shpenzuar shuma 449,794.17€ ose 22.49 %. Në total Buxheti i MAPL-së + Donacionet (93 Council of Europe dhe WB-Banka Botërore) për periudhën Janar-Dhjetor është shpenzuar në vlerë prej: 7,856,779.34 € ose 60.74 % e buxhetit

MAPL për periudhën Janar-Dhjetor 2023 ka iniciuar 1 kërkesë për rekrutimin-lëvizje brenda kategorisë, sipas procedurave të brendshme të rekrutimit. Janë përgatitur dy njoftime për përzgjedhjen e kandidatëve të suksesshëm për lëvizje brenda kategorisë, janë rekrutuar dy (2) zyrtar të ri dhe është pranuar një drejtor departamenti transfer të përhershëm. Është përditësuar baza elektronike me të dhëna për stafin e MAPL-së, është bërë menaxhimi i udhëtimeve zyrtare (252 kërkesa për udhëtime zyrtare) dhe menaxhimi i pushimeve vjetore, mjekësore. Janë identifikuar nevojat për trajnime dhe është përgatitur plani i trajnimeve. Gjithashtu janë koordinuar aktivitetet me IKAP-in sa i përket fushës së trajnimeve të stafit, ku kanë marrë pjesë 9 zyrtarë në trajnime nga gjithësej 68 trajnime të organizuara nga IKAP. Janë realizuar gjithësej 282 kërkesa për ndryshime në paga prej të cilave i kemi: 104 ndryshime, 18 largime nga puna, 15 punëtor të rinjë, 1 transfer të përkohshëm, 2 transferime të përhershme (largime), 8 ndërrime të llogarisë bankare, 107 pagesa retroaktive dhe 6 marrëveshje për praktik bazuar në vendimin e Qeverisë. Janë përgatitur raportet mujore të vijueshmërisë për stafin.

Për këtë periudhë raportuese sipas njoftimit të pranuar nga Agjensioni Kundër Korrupsioni janë njoftuar gjithë zyrtarët e lartë se si bëhet deklarimi i pasurisë përmes sistemi dhe i gjithë procesi është përfunduar përmes këtij sistemi. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë përgatitur dhe dërguar të dhënat dhe dokumentet sipas kërkesës së Auditorëve të Brendshëm dhe të Jashtëm për gjithë punonjësit e MAPL-së.

5.2. Auditimi i Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) ka përmbyllur punën e vitit 2022 duke hartuar raportin e gjashtëmujorit të dytë të vitit 2022 dhe raportit vjetor të punës së NJAB për vitin 2022 i cili është proceduar tek menaxhmenti i lartë i MAPL-së dhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm (NJQH-AB).

Njësia e Auditimit të Brendshëm në përputhje me Planin vjetor 2023, ka përfunduar auditimet si në vijim:

- *“Menaxhimi i automjeteve në MAPL”*
- *“Menaxhimi i burimeve njerëzore në MAPL”*

Është përgatitur dhe proceduar në NJQH-AB dhe tek menaxhmenti i lartë i MAPL-së raporti i gjashtëmujorit të I-rë dhe gjashtëmujorit të II-të të punës së NJAB-së. Janë mbajtur katër takime me Komitetin e Auditimit. Gjithashtu janë finalizuar raportet si në vijim:

- *“ Sistemi i menaxhimit të buxhetit”*
- *“Sistemi i menaxhimit të prokurimit”*
- *“Sistemi i menaxhimit të prokurimit”.*
- *Menaxhimi i investimeve kapitale në MAPL për vitin 2023”*

Është përgatit Plani Strategjik 2024-2026 dhe Plani Vjetor i NJAB-së për vitin 2024 dhe pas miratimit nga Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik/ Ministri dhe Komiteti i Auditimit janë dërguar në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve konkretisht në Njësinë Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm-NJQH-AB.

5.3. Prokurimi

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, divizioni i prokurimit ka zhvilluar aktivitetet në kuadër të kontratave të planifikuara: *kontrata për furnizim, kontrata për shërbime dhe kontrata për punë*:

- Në kuadër të ***kontratave për furnizim*** janë përfunduar gjitha artikujt sipas kontratës për furnizim për zyre, kontratës furnizim me IT për MAPL, kontratës për furnizim me Inventar, kontratës për furnizim me pajisje tjera të IT – së ndërsa për kontratën furnizim për zyre për BNK kanë përfunduar artikujt sipas kërkesave të pranuar përveç artikullit “Furnizim me material të vizibilitetit dhe dukshmerise Programi KS- MK” për të cilin nuk ka pasur kërkesa.
- Në kuadër të ***kontratave për shërbime*** janë përfunduar gjitha artikujt sipas kontratës “Mirëmbajtja dhe zhvillimi në SMPK”, kontratës “E-Komunat”, kontratës “Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve të veturave”, kontratës “Shërbimet e përkthimeve”, kontratës “Pastrimi i veturave zyrtare të MAPL – së”, kontratës “Kontrollimi teknik”. Sa i përket kontratës për “Ofrimit i shërbimeve të PR-it për nevoja të MAPL-së” është anuluar.
- Në kuadër të ***kontratave për punë*** është përfunduar artikulli sipas kontratës “Rregullimin e rrjetit të ujësjellësit në Komunën e Fushë Kosovës në Lagjen 028 dhe 029 Bardh i Madh si dhe Fshatin Sllatinë e Madhe (buxheti i këtij projekti është planifikuar në MMPHI)”.